



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0653-A0001

Në çështjen juridike të:

Paditësja/ankuesja

Sh R, Prishtinë.

Kundër:

E paditura

N.SH "Auto Prishtina" (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-15-0712, të datës 08 shkurt 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditëses e paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV.-15-0712, të datës 08 shkurt 2021, hedhet poshtë si e pa pranueshme.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 29 prill 2015, paditësja kishte parashtruar padi në DHPGJSK, kundër të paditurës AKP-së, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e tij dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë shumën 54,470.00 euro, në emër të kompensimit dhe pagave për periudhën nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor të viti 2014, si punëtor i NSH "Auto Prishtina" (në likuidim). Paditësja në padi ka theksuar se ka qenë i punësuar pranë NSH-së "Auto Prishtina" dhe se pala e paditur me shkresën me numër të protokollit 15373, ishte njoftuar për fillimin e procesit të likuidimit të Ndërmarrjes i cili ka filluar me datën 21.07.2014. Po ashtu është njoftuar edhe për anulimin e të gjitha kontratave të punës të cilat deri atëherë kanë qenë në fuqi. Më datën 12 qershor 2014 se bashku me të punësuarit e tjerë në ndërmarrje nëpërmjet menaxhmentit dhe kryesisë së sindikatës kishin depozituar një regjistër e cila përmbante emrin dhe mbiemrin e secilit të punësuar në ndërmarrje, pagat mujore, akontacionet e marra nga NSH-ja, dhe pagat që kishin mbetur të pa paguara për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014. Paditësja ka theksuar se në mes të menaxhmentit, këshillit drejtues dhe sindikatës në njërën anë dhe ndërmarrjeve private me pronarë B S ishin krijuar raporte të dëmshme për NSH dhe se menaxhmenti në bashkëpunim me palën e paditur nuk kishin arritur t'i normalizojnë këto raporte, si rezultat i këtyre raporteve pala paditëse është dëmtuar me mos pagesë të pagave për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014. Në vazhdimësi ka kërkuar kompensimin e pagave mujore sipas kontratës së punës deri në njoftimin në lidhje me procesin e likuidimit të ndërmarrjes. Pran Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë brenda afatit ku ka kërkuar kompensimin, mirëpo Autoriteti i likuidimit e ka refuzuar kërkesën për kompensimin e pagave edhe përkundër faktit se kërkesa ka qenë e parashtruar brenda afatit dhe ka pasur prova të mjaftueshme. Paditësja në padi i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tersi si të bazuar kërkesën e tij dhe të detyrohet pala e paditur që palës paditëse t'ia paguajë borxhin-pagat e pa paguara për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014 , në shumën e përgjithshme prej 54,470.00 euro me normë të kamatës prej 3.5 % në vit. Paditësja ankesës i ka bashkangjitur: Autorizimin për përfaqësim, Listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat

sipas kontratës së punës, kontratën e punës të vitit 2003, një deklaratë, librezën e punës, njoftimin e autoritetit të likuidimit për ushtrimin e padisë dt. 23 prill 2015.

Me parashtresën e dt. 10 dhjetor 2020, paditësja ka paguar taksën gjyqësorë dhe ka dorëzuar në DHPGJS autorizimin për përfaqësim nga avokati në lëndën C-IV-15-0712.

Më 02 shkurt 2021, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditëses theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditëses duke i konsideruar të pa bazuar në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. E paditura theksoi se NSH, "Auto Prishtina" ka hyrë në procedurën e likuidimit më 21 korrik 2014, më datën 11 shtator 2014, pala paditëse pranë saj ka parashtruar kërkesë me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave në shumën prej 54,470.00 euro. Autoriteti i Likuidimit me vendimin PRN126-0129, të datës 31 mars 2015, e ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga paditësja në atë procedure. Ka shtuar se Autoriteti i Likuidimit e ka marrë vendimin për refuzimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 36.2 1 Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 dhe nenit 608 të ligjit për punën e Bashkuar (i aplikueshëm sipas nenit 1 të rregullores së UNMIKUT 199/24 është përcaktuar se pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tri vite.

E paditura kishte theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se saktë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. E paditura thekson se pretendimet e paditëses janë parashkruar ngase nuk ka asnjë prove që para Autoritetit të Likuidimit, që parashtruesja e ka dorëzuar kërkesë pranë gjykatës apo organit tjetër kompetent nga tetori i vit 2003. Më tutje ka shtuar se asetet e ndërmarrjes janë dhënë me qira për gjatë periudhës kontestuese dhe se ndërmarrja nuk ka kryer asnjë funksion të saj, por menaxhmenti vet i ka emëruar ka marrë të ardhura nga qiradhënia e aseteve të NSH-së.

Më 08 shkurt 2021, Shkalla e parë e DHPGJSK-së ka marrë Aktgjykim C-IV-15-0712, me të cilin e kishte refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në NSH "Auto Prishtina", gjë që ishte vërtetuar nga kontrata e punës e cila gjendet në shkresat e lëndës. NSH "Auto Prishtina" me datën 21 korrik 2014, ka hyrë në procedurën e likuidimit, ku Autoriteti i Likuidimit duke u bazuar në nenin 8 të Shtojcës së Ligjit me nr.04/L034, për AKP-në në të cilin parashihet se "mesnatën e datës së vendimit për likuidim, ndërpriten të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë", i ka ndërprerë të gjitha kontrata ekzistuese. Tutje ka arsyetuar se paditësja pranë Autoritetit të Likuidimit me datën 11.09.2014, ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse dhe me vendimin PRN 126-0129, të datës 31 mars 2015, kërkesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së ka arsyetuar se paditësja ka pretenduar në borxh për shkak të mos pagimit të pagave e që i referohet periudhës nga tetori 2003 e deri në qershor 2014, ndërsa në anën tjetër pala e paditur ka pretenduar se në rastin konkret borxhi i pretenduar nga paditësja është parashkruar. Shkalla e I-rë ka konstatuar se në bazë 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) në mënyrë shprehimore është e përcaktuar se "kërkesa e shpërblimit të demit të shkaktuara parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin". Në rastin konkret borxhi i pretenduar nga pala paditëse i përket periudhës nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor 2014, andaj në kuptim të dispozitës ligjore të cituar kërkesa e paditëses është refuzuar.

Më 01 dhjetor 2022, paditësja/ankuesja ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të Shkalla e I-rë C-IV-15-0712, për shkak të të gjitha arsyeve ankimore duke propozuar që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim ose rivendosje në Shkallë të I-rë të DHPGJSK-së.

Paditësja në ankesën e parashtruar e kundërshton arsyetimin e aktgjykimit dhe thekson se i njëjti është kontradiktor ngase sipas arsyetimit se parashkrimi i kërkesës mund të krijohet nëse pala e dëmtuar nuk e kërkon të drejtën e vet brenda tri vitesh. Paditësja në ankesën e parashtruar konsideron se nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendja faktike. Nuk është vërtetuar fakti

vendimmarrës se paditësja ka marr vetëm akontacion të pagës e jo pagë të plotë, po ashtu nuk është vërtetuar fakti se e paditura në mënyrë të tërthortë ka pranuar ekzistimin e borxhit, andaj sipas ankueses aktgjykimi duhet prishur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Po ashtu për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhur edhe deri të aplikimi i gabuar i së drejtës materiale kur Gjykata e ka refuzuar kërkesë padinë e paditëses me të cilën ka kërkuar që e paditura t'ia paguajë borgjin-pagat e pa paguara në shumë prej 54,470.00 euro, andaj sipas ankuese shkalla e I-rë me rastin konkret gabimisht e ka aplikuar dispozitën e nenit 99 al.12 të LPK-së ngase kërkesë padia i përmbanë të gjitha elementet e paraparë me këtë nen. Po ashtu paditësja ka theksuara se avokati Sh B nuk ka pasur autorizim për përfaqësim dhe se K B nuk ka mundur ta përfaqësoj atë në gjykatë.

Më 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit këtë ankesë e ka dërguar tek AKP për përgjigje. Në përgjigjen e datës 22 dhjetor 2023, AKP konsideron se aktgjykimi i Shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe si i tillë duhet të konfirmohet. E paditura thekson se lidhur me argumentet e ankesës është qartësisht dhe mjaftueshëmerisht e sqaruar në mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me nr.C-IV-15-0712 të DHPGJS-së, pranë Shkallës së I-rë. Përsëritja e këtyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i parashtron Kolegjit të Apelit që t'i referohet mbrojtjes dhe aktgjykimit përkatës. AKP ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me 15 shkurt 2024, paditësja ka paraqitur një parashtrësë për azhurnimin e procedurës gjyqësore , në mënyrë që kërkesa e saj të procedohet. Paditësja përsërit pretendimet e saj si në ankesë dhe të njëjtës parashtrësë i ka bashkangjitur një Aktgjykim të Shkallës së I-rë te DHPGJS C-IV-15-0679 të dt. 11.02 2002 duke ju referuar se për çështjen e njëjte një paditësi tjetër M B gjykata i ka aprovuara kërkesëpadinë. Me këtë parashtrësë paditësja pohon se ajo për aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka ditur me herët që ishte lëshuar nga Gjykata, por në momentin

që e ka siguruar marrjen e aktgjykimit me dt. 05.11.2022, brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë në DHPGJS.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pa pranueshme.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit në këtë rast konkret nuk është lëshuar fare në meritat e ankesës, pasi që ajo është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, shkalla e parë e DHPGJS-së ka dhënë këshillën ligjore për palët në procedurë, duke i udhëzuar ato që afati i ankesës ndaj këtij Aktgjykimi është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi.

Kolegji i Apelit vëren se me parashtresën e dt. 10 dhjetor 2020, në DHPGJS është dorëzuar taksa e paguara gjyqësore dhe autorizimi për përfaqësim nga avokati Sh B në lëndën C-IV-15-0712.

Kolegji i apelit vëren se përfaqësuesi i paditëses Aktgjykimin e Shkallës së I-rë C-IV-15-0712 të dt. 08 shkurt 2021, e ka pranuar me datë 12.03.2021, gjë që është vërtetuar nga fletë kthesa e gjykatës, ndërsa ankesën kundër këtij aktgjykimi paditësja e ka parashtruar në DHPGJS me 01 dhjetor 2022.

Pra paditësja, kundër këtij Aktgjykimi e ka paraqitur ankesë në DHPGJS me datë me 01 dhjetor 2022, që do të thotë 16 muaj pas kalimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankesës.

Po ashtu edhe pretendimi i paditëse i ngritur me parashtresën e dt. 15 shkurt 2024, se për aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka ditur me herët që ishte lëshuar nga Gjykata, por në momentin që e ka siguruar marrjen e aktgjykimit me dt. 05.11.2022, brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë në DHPGJS, po ashtu sipas Kolegjit të Apelit është i pabazuar. Ngase edhe nëse konsiderojmë se paditësja ashtu siç ka theksuar "Nga momenti që e ka siguruar marrjen e Aktgjykimit me refuzim me datën 05.11.2022, brenda afatit ka ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Suprem C-IV-15-0712", përsëri ankesa e paditëses është paraqitur jashtë afati ligjor sepse nga data 05.11.2022, kur paditësja siç ka pohuar vet e ka siguruar aktgjykimin e kundërshtuar e deri në paraqitjen e ankesës në Kolegj të Apelit kanë kaluar me tepër se 24 ditë, ndërsa afati për paraqitjen e ankesës ndaj aktgjykimit në fjalë ka qenë 15 ditë.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e hedhë poshtë si të pa pranueshme ankesën e paditëses, pasi që e njëjta nuk është parashtruar brenda afatit ligjor si parshëni 9 paragrafi 6 i Ligjit të DHPGJSK-së.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9 paragrafi 9 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Paditësja/ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 13 dhjetor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 21 mars 2024.

Mr.Sc, Sahit Sylejamani Gjyqtar kryesues
